

BASHKIA PERMET

*RAPORTI TEKNIK*

RIKONSTRUKSION ME NDRYSHIM  
FUNKSIONI NGA ISH CERDHE NE QENDER  
RINORE, QYTET PERMET



## INFORMACION I PERGJITHSHEM

### VENDODHJA

PERMET, ALBANIA



## PERSHKRIMI I PERGJITHSHEM

### -HYRJE

Ish kopshti ndodhet ne lagjen Varosh, PERMET.

Ish kopshti eshte e pozicionuar ne pjesen fundore te lagjes Varosh dhe kufizohet nga daljet ne rruge nga fasada lindore

**Pozicioni ne Rajon**



**Foto te Gjendjes Aktuale**



### **Pershkrim I gjendjes ekzistuese**


Gjendja ekzistuese e objektit na paraqitet me problemet e meposhtme nga inspektimi:

- Dëmtim I suvase dhe bojës së fasadës së jashtme
- Pjesa e pasme dhe anësore ka presencë lageshtie.
- Dëmtim I dyshemese me disnivele të parketit dhe formimin e zonave me lageshtire.
- Amortizim I suvase në ambjentet e brendshme
- Mungesë të sistemit të ngrohjes
- Dëmtim I tavaneve duke përfshirë suvan, lageshti të tepert dhe me rrezik rënie.
- Dëmtim I tualeteve në dysheme, sistemin e furnizimit me ujë dhe në funksionalitetin e tyre.
- Dëmtim I terraces të cilat përkrahin duke depertuar edhe me shumë lageshtira në periudhë dimri.
- Pjesa e jashtme ka disnivele të ndryshme që lejojnë formimin e pellgjeve me ujë në pjesën e oborrit
- Dëmtime të konsiderueshme në rrjetin e kanalizimeve dhe lokalizimin e ujërave të shiut.


### **Punimet që do realizohen**

Nisur nga problemet e mësipërme është vendosur të kryhet një projekt që përfshin:

- Sipas situates aktuale ne pjesen e brendshme eshte bere nje rikonstruksion i plote i te gjitha ambjenteve lidhur se pari me rigrupimimin dhe riorganizimin e tyre, riparimin e tualeteve , rrjetit te jashtem dhe sistemimin e oborrit.
- Riorganizim I hyrjes perfshin shtimin e receptionit dhe hapjen e ambjeve ne salla me te medha dhe me funksionale.




- Ne katin e dyte do hapjen te katerta dhomat si dhe do te behet nje riorganizim funksionesh nje ambient do te sherbeje per salle kercimi dhe tre ambjente te tjera per zyre takimesh midis te rinjve



- Rikonstruksion I plote I dyshemeve te dhomave duke perfshire heqjen e parketit ekzistues dhe veshja me hidroizolim duke shmangur perseri problemet e lageshtise.
- Rikonstruksion I plote I suvase se tavaneve te cdo kati dhe I tarraces sipas detajit te meposhtem.





- Shkallet do te pajisen me korimano ne njeren ane dhe tjetren me mbeshtetese ne murin me lartesi mbi 50 cm.
- Sistemim I gjithe rrjetit te ujrave te shiut me ane te zgarave te shiut, tubacioneve, ulluqevet horizontale dhe vertikale.
- Rehabilitimi I tualeteve
- Rrjeti I ri I sistemit te shkarkimit qe do lidhet me ate ekzistues.
- Sistemit te ri elektrik me ndricim me parametrat e duhura per secilin ambient.
- Eshte bere gjithashtu dhe termoizolimi I objektit, kjo duke bere te mundur shmangien e humbjeve te nxehtesise duke ulur keshtu konsumimin e energjise per ngrohje.
- Dritaret jane mundesuar dritare termike me profile alumini me dopio xham me koeficient te ulet te transmetimit te energjis, gjithashtu xhami i jashtem do te jete transparent ne menyre qe te gjithe ambientet te marrim ndricimin maksimal.

### Pamjet e Objektivit



Duke bere rikonstrukcionin e objektit eshte bere I mundur dhe permiresimi I kushteve te ambjenteve perreth

- Ne pjesen e sheshit do te shtrohet me pllaka guri natyral dhe ambjente me gjelberim, lulishte.
- Do behet rikonstruksion total I sheshit.
- Do behet risistemim I hapsires se gjelbert.

HARTOI: ZYRA E URBANISTIKES BASHKIA PERMET

ARK. ELVJON MUSAJ

PERMET 2022